



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.3.2023

Nr: 102

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**PËR SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 17 SHKURT - 23 SHKURT 2023**

Sot, më datë 8.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit, Ministër i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Banka e Shqipërisë, Muzeu Historik Kombëtar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Shërbimi i Provës, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë, Bashkia Kurbin, Bashkia Lezhë, Bashkia Mat, Bashkia Roskovec, Bashkia Sarandë, Bashkia Shkodër, Bashkia Tepelenë.

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të organeve publike për periudhën 17 shkurt deri më 23 shkurt 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 17 shkurt deri më 23 shkurt 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 244 aktivitete, nga 59 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto, 26 aktivitete të zhvilluara nga 17 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Në datë 24.2.2023, administrata e KQZ i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 1.3.2023, ora 11:00.

Palët e interesuara depozituan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktiviteti "Inspektim në Spitalin e Shkodrës" raportuar në datën 17.2.2023 për tu zhvilluar në datën 21.2.2023
 - "Zbatimi i Programit të Mbështetjes me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për nënat me shumë femijë" raportuar në datën 21.2.2023 për tu zhvilluar në datën 21.2.2023

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet email-it të datës 1.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar maksimalisht për raportimin në kohë dhe shterues të të gjitha aktiviteteve me karakter publik në përputhje me nenin 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve"*

Në lidhje me vonesën në raportimin e aktiviteteve të sjella në vëmendje, ju bëjmë me dije se ditën e Enjte, datë 16.2.2023, është bërë nga ana e MSHMS publikimi i aktiviteteve me karakter publik për ditët në vijim dhe është vënë re dhe nga ana jonë se keto dy publikime specifikisht nuk kanë qenë të ruajtura në ndërfaqe për shkak të problematikave me sistemin.

Në këto kushte, në kuadër të detyrimit për të raportuar çdo aktivitet me karakter publik, aktivitetet e sipërpërmendura janë raportuar duke dhënë dhe një përshkrim sqarues për secilin "Ky publikim është bërë në datën 16 por po ripostohet përsëri pasi nuk rezulton i shfaqur në ndërfaqe".

Në këto kushte, duke mirëkuptuar rastet e problematikave që shkakton sistemi në ndërfaqe, tërheq vëmendjen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që në vijim, kur është i pamundur teknikisht aksesimi i ndërfaqes, të dërgojnë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor.

2. Ministria e Turizmit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

-Aktivitet “Ftesë pjesëmarrjeje në Konferencën Kombëtare Zgjedhore të Organeve Drejtuese të Shoqates së Restoranteve dhe Bujtinave Shqiptare” raportuar në datën 20.2.2023 për tu zhvilluar në datën 22.2.2023

Ministria e Turizmit nëpërmjet email-it të datës 27.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Lidhur me aktivitetin që është zhvilluar me datë 22.02.2023 ora 11:00 në Tiranë, pranë Tirana International Hotel, i cili është publikuar më datë 20.02.2023, ju bëjmë me dije se, ky aktivitet nuk është publikuar në kohë për shkak të problemeve teknike (internet), për të komunikuar me e-mail, dhe më pas raportimin e aktivitetit në kohë. Nisur nga kjo situatë, menjëherë pas publikimit të aktivitetit kemi përcjellë një e-mail në adresën: institucione@kqz.gov.al, duke bërë me dije dhe sqaruar mbi arsyet e publikimit të aktivitetit vetëm dy ditë para zhvillimit të saj. Sa më sipër, ky informacion mund të verifikohet në e-mailin e përcjellë më datë 20.02.2023, në të cilin është dhënë një sqarim më i detajuar.*

Është bërë verifikimi i e-mailit të dërguar më parë prej tyre, i datës 20.2.2023 në të cilin pretendohet si më poshtë: Në vijim të e-mailit të mëposhtëm, të përcjellë më datë 17.2.2023, ju bëj me dije mbi një aktivitet që do të zhvillohet me datë 22.2.2023 ora 11:00 në Tiranë, pranë Tirana International Hotel, në të cilën do të marrë pjesë znj. Vilma Bello, zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, si e ftuar në këtë aktivitet. Publikimi i këtij aktiviteti, në faqen e KQZ-së, është bërë ditën e sotme datë 20.02.2023, dhe nuk është publikuar ditën e premte datë 17.02.2023, për shkak të problemeve teknike (internet), për të komunikuar me e-mail, dhe më pas raportimin e aktivitetit në kohë. Bashkëlidhur emailit është dhe ftesa që provon prezencën e Zv.Ministres si e Ftuar në këtë aktivitet.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministria e Turizmit nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

3. Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktiviteti “Vizita e punës në Podgoricë, me rastin e mbajtjes së mbledhjes së përbashkët të qeverive Shqipëri-Mal i Zi”, raportuar në datën 23.2.2023 për tu zhvilluar në datën 27.2.2023

Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, nëpërmjet përfaqësuesit të tij në seancë publike, ka paraqitur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *Ministria në lidhje me veprimtaritë e raportuara me vonesë, javën e kaluar nuk ka patur kredencialet për aksesimin e ndërfaqes së raportimeve. Në lidhje me njoftimin e ardhur ditën e premte për aktivitetin “Vizita e punës në Podgoricë, me rastin e mbajtjes së mbledhjes së përbashkët të qeverive Shqipëri-Mal i Zi”, është njoftuar për tu zhvilluar në datën 23.2.2023 dhe skemi patur mundësi ta raportojmë në afat, e kemi raportuar po në datën 23.2.2023 që na ka ardhur njoftimi. Për sa më sipër, pretendohet se Ministria ka qenë pjesë e delegacionit qeveritar që do të merre pjesë në takim, dhe është njoftuar në moment të fundit. Për sa më sipër, nëpërmjet emailit të datës 1.3.2023 është dërguar edhe ftesa zyrtare për Ministrin e Shtetit për Standartet dhe Shërbimet.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se mbledhja e përbashkët e dy qeverive nuk konsiderohet si veprimtari me karakter publik dhe për këtë arsye, nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

4. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- Aktiviteti “Event Përkujtimor 1 Vit nga fillimi i luftës në Ukrainë” raportuar në datën 22.2.2023 për tu zhvilluar në datën 24.2.2023.

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, nëpërmjet email-it të datës 28.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Aktiviteti “Event Përkujtimor 1 Vit nga fillimi i luftës në Ukrainë”, ishte një aktivitet i Ambasadës së Ukrainës dhe Bashkisë Tiranë, si i tillë raportuar nga kjo e fundit në afat. Duke qenë se në datën 22 Shkurt Ministria Spiropali u ftua dhe të mbante fjalë, çmova ta raportoja dhe pse jashtë afatit. Qëllimi ishte vetëm për faktin se Ministria do të mbante fjalë (që në fakt mandej nuk mbajti).*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore

dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Banka e Shqipërisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Vizitë pune në Bankën e Shqipërisë, në kuadrin e dialogut me partnerët evropianë për vlerësimin e programit të reformave ekonomike për vitin 2023”, raportuar në datën 20.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 17.2.2023

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet email-it të datës 27.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Në vijim të emailit tuaj, ju bëjmë me dije se ky aktivitet nuk ka qenë i parashikuar më parë në kohë. Gjatë vizitës 1-ditore të ekspertëve të Bankës Qendrore Evropiane, është kërkuar prej tyre të realizohej një takim përmbyllës me Guvernatorin dhe takimi është realizuar në momentin e fundit. Gjithashtu, dalja me njoftim për shtyp ka qenë subjekt konfirmimi dhe i Bankës Qendrore Evropiane, gjë që ka marrë kohën e vet dhe, jo vetëm që nuk mund të parashikohej paraprakisht, por mund të rezultonte edhe në mosaprovim prej tyre. Pas realizimit të takimit është përgatitur njoftimi për shtyp dhe pas konfirmimit nga BQE është publikuar dhe raportuar menjëherë pranë institucionit tuaj. Ndërkohë duke marrë shkas nga korrespondencat e fundme që kemi patur në këtë drejtim, do të vlerësonim realizimin e një takimi me përfaqësues të institucionit tuaj, me qëllim sqarimin e disa pikave që prekin raportimin tonë në përputhje me aktet juridike në fuqi.*

Në datën 17 shkurt 2023, një delegacion nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) zhvilloi një vizitë pune në Bankën e Shqipërisë, në kuadrin e dialogut me partnerët evropianë për vlerësimin e programit të reformave ekonomike për vitin 2023. Ky aktivitet ka qenë vizitë e një delegacioni në Bankën e Shqipërisë, zhvilluar pa praninë e medias dhe publikut.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, nisur nga tematika e aktivitetit të zhvilluar, dhe nga sa informacion jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

6. Muzeu Historik Kombëtar ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Organizim i Lëvizjes BASHKE me anëtarët e saj” raportuar në datën 23.2.2023 për tu zhvilluar në datën 27.2.2023

Muzeu Historik Kombëtar, nëpërmjet email-it të datës 27.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Raportimi i veprimtarisë “Organizim i Lëvizjes Bashkë me anëtarët e saj” nuk është një aktivitet ku punonjës të institucionit Muzeu Historik Kombëtar do të marrin*

pjesë, por është një kërkesë për marrje me qera të një prej sallave të muzeut për zhvillimin e aktivitetit. Më datë 23.02.2023, ora 12:00, pranë Muzeut Historik Kombëtar u paraqit kërkesa e Zj.Vitori Cipi, anëtare e sekretariatit të Lëvizja BASHKE, për të marrë me qera sallës UNESCO të Muzeut Historik Kombëtar, kjo është arsyeja e publikimit më datë 23.02.2023. Arsye tjetër e publikimit të kësaj kërkesë, duke menduar se ishte Lëvizje e regjistruar politike, ishte vetëm marrja nga ana e KQZ e një aprovimi për pranimin e kërkesës, por pasi folëm me znj. Cipi na siguroi se do të ishte një aktivitet nën emrin e saj. Siç edhe mund ta shikoni, tek përshkrimi i shkruar qartësisht shkruhet se është një kërkesë për marrje me qera të sallës UNESCO nga ana e znj. Cipi. Ndoshta për arsyen e publikimit nuk duhet të ishte publikimi në portal, por vetëm dërgimi i një e-maili të thjeshtë, dhe vetëm ky është gabimi jonë njerëzor.

Për të vërtetuar se kjo është një kërkesë për marrje me qera të sallës UNESCO të Muzeut Historik Kombëtar nga ana e Vitori Cipi, anëtare e sekretariatit të Lëvizja BASHKE, po ju dërgojmë bashkëlidhur kërkesën e skanuar ku nuk specifikohet se është një aktivitet politik i kësaj organizate. Dhe gjithashtu, për të evituar moszbatimin e ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” për personin në fjalë që merr me qera sallën e konferencave të Muzeut Historik Kombëtar, në kontratën e sallës me qera, shtuam bazën ligjore të lartpërmenduar, kontratë të cilën po jua nisim bashkëlidhur.

Bashkëlidhur emailit është kontrata e qerasë për zhvillimin e aktivitetit dhe kërkesa për marrjen me qera të sallës “Unesco”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatoi se nuk jemi përpara një veprimtarie me karakter publik të institucionit të Muzeut Historik Kombëtar. Për këtë veprimtari nuk ka detyrim për t’u raportuar, pasi është një marrëdhënie kontraktuale ndërmjet Muzeut dhe palëve të treta.

7. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

-Aktiviteti me temë “Reflektim i IoAFP-ve për procesin e vetëvlerësimit dhe diseminim e komunikim me grupet e interesit për nisjen e procesit të akreditimit”, raportuar në datën 20.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 20.2.2023.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional, nëpërmjet email-it të datës 27.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: “Aktiviteti “Reflektim i IoAFP-ve për procesin e vetëvlerësimit dhe diseminim e komunikim me grupet e interesit për nisjen e procesit të akreditimit”, raportuar në datë 20.2.2023 dhe datë zhvillimi 20.2.2023” është anulim i aktivitetit sipas emailit të mëposhtëm. Nuk kemi raportuar për zhvillim aktiviteti. Pra, ky postim është për anulim aktiviteti.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se, aktiviteti i sipërcituar nuk është zhvilluar. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për atë kohë sa veprimtaria nuk është zhvilluar dhe raportimi në ndërfaqe është bërë për të anuluar veprimtarinë e zhvillimit të aktivitetit të mëparshëm.

8. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon
- Aktiviteti “Analiza e punës e realizuar nga Drejtoritë Rajonale për t’u njohur me rezultatet, problematikat gjatë vitit 2022 dhe sfidat e 2023”, raportuar në datën 17.2.2023 për tu zhvilluar në datën 21.2.2023

Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk ka paraqitur pretendimet e veta me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike, nuk ka qënë prezentë në seancë publike.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura në raportim dhe postimet e kryera në Rrjetin Social Facebook vlerëson se aktiviteti i raportuar prej ISSH, zhvillohet sipas programit të punës që ka institucioni, dhe këto mbledhje “Analiza vjetore Pune” nuk janë aktivitete që zhvillohen me qëllim informimin e publikut, në vetvete përbëjnë veprimtari administrative që lidhen me veprimtarinë funksionale të institucionit.

Për sa me lart, analiza e punës së ISSH nuk konsiderohet si veprimtari me karakter publik.

9. Shërbimi i Provës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 4 (katër) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
- “Në TV Scan, Intervistë në studio, pa panel, mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dhe aktivitetet e Sh.P, Marrëveshja me Shërbimin Sprovues të Kosovës, etj” raportuar në datën 20.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 24.2.2023
 - “Takim me prokurorë të Prokurorisë së rrethit gjyqësor, me qëllim diskutimin e problematikave të hasura lidhur me zbatimin e dënimeve alternative/masave alternative” raportuar në datën 20.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 24.2.2023
 - “Takim me prokurorë të Prokurorisë së rrethit gjyqësor me qëllim diskutimin e problematikave të hasura lidhur me zbatimin e dënimeve alternative/masave alternative” raportuar në datën 20.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 24.2.2023
 - “Takim me prokurorë të Prokurorisë së rrethit gjyqësor me qëllim diskutimin e problematikave të hasura lidhur me zbatimin e dënimeve alternative/masave alternative” raportuar në datën 20.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 24.2.2023

Shërbimi i Provës, nëpërmjet email-it të datës 27.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Bazuar në pikën 4, të nenit 4, kreut III të Vendimit Nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, ku përcaktohet se raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë*

përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik, nga ana jonë afati 5 (pesë) ditor është konsideruar nga data e raportimit deri në datën e zhvillimit të aktivitetit (nga data 20.02-24.02.2023). Ju bëjmë me dije se për shkak të raportimit të parë të bërë nga ana jonë ka lindur ky keqkuptim mbi afatin e raportimit. Në vijim të raportimeve do të mbajmë në konsideratë cdo udhëzim tuajin. Gjithashtu nëse ju e shikoni të arsyeshme, shprehim gadishmërinë për t'u paraqitur në seancë publike."

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet vlerëson se, vonesa e raportimit të veprimtarisë publike ka ardhur nga llogaritja e gabuar e afatit 5 (pesë) ditor. Në llogaritjen e afatit është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati. Konstatohet se Shërbimi i Provës ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit.

Për këtë arsye, duke u përpjekur për të mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, i tërheqim vëmendjen Shërbimit të Provës, që në vijim të kryejnë llogaritjen e afatit 5 (pesë) ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

10. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet "Analiza vjetore e punës së kryer për vitin 2022 nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë", raportuar në datën 20.2.2023 për tu zhvilluar në datën 23.2.2023.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë, nëpërmjet email-it të datës 25.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *"Analiza Vjetore është një rutinë për Institucionet, e cila zhvillohet çdo fillim viti. Të pranishëm ishin vetëm punonjës, pa praninë e mediave dhe jo i hapur për persona të tjerë. Ditën e premte me datë 17.2.2023 është vendosur data që do të zhvillohet "Analiza Vjetore e vitit 2022", dhe për shkak të ngarkesës së punës është harruar raportimi në faqen e KQZ dhe na u duk e papërshtatshme të raportonim në fundjavë. Ditën e parë të punës është bërë raportimi".*

Për sa me lart, analiza e punës e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë nuk konsiderohet si veprimtari me karakter publik.

11. Bashkia Kurbin ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim i ecurisë së punimeve” raportuar në datën 21.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 24.2.2023,
- Aktiviteti “Inspektim i ecurisë së punimeve” raportuar në datën 21.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 25.2.2023

Bashkia Kurbin, nëpërmjet emailit të datës 27.2.2023 si dhe shkresës nr. 1231 prot, datë 27.02.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Përsa i përket dy veprimtarive, Aktivitet “Inspektim i ecurisë së punimeve”, raportuar nga ana jonë me datë 21.02.2023, për tu zhvilluar me datë 24.02.2023 dhe Aktivitet “Inspektim i ecurisë së punimeve” , raportuar nga ana jonë me datë 21.02.2023, për tu zhvilluar me datë 25.02.2023, ju sqarojmë se kemi tentuar që këto veprimtari ti raportojmë me datë 17.02.2023, por kemi patur vështirësi me hapjen e kredencialeve për të aksesuar në ndërfaqen e raportimeve. Në lidhje me këtë problem kemi kontaktuar me anë të telefonit me përfaqësues të KQZ-së dhe jemi identifikuar si përdorues në ndërfaqen e raportimeve me datë 21.02.2023 dhe në këtë datë kemi vepruar në raportimin e veprimtarive publike të cituara më lart. Gjithashtu, sqarojmë se këto dy veprimtari të raportuara me datë 21.02.2023 nuk janë zhvilluar si inspektim dhe si pasojë as publikuar për shkak të ndryshimit të programit të punës së kryetarit. Për veprimtaritë e cituara më lart do të raportojmë sipas afateve ligjore të përcaktuara në nenin 92 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.*

Bashkëlidhur kanë nisur shkresën nr. 1231 prot, datë 27.02.2023 “Informacion sqarues”, të cilën e kanë dërguar edhe me anë të shërbimit postar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se, janë kryer të gjitha përpjekjet për ta raportuar në kohë, por për shkak të pamundësisë teknike nuk është arritur të bëhet. Gjithashtu, merret në konsideratë fakti që aktivitetet e raportuara me vonesë nuk janë zhvilluar dhe në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është kryer.

12. Bashkia Lezhë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Bashkia Lezhë dhe UNWOMEN do nënshkruajnë marrëveshjen për respektimin e Kartës Evropiane për Barazi”, raportuar në datën 17.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 20.2.2023,
- Aktiviteti “Konkurs mbarëkombëtar për çmimin letrar “At Zef Pllumi”, edicioni i vitit 2023”, raportuar në datën 20.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 24.2.2023,
- Aktiviteti “Inspektim i punimeve në segmentin rrugor pranë vendit të quajtur “Ura e zezë”, Lezhë”, raportuar në datën 21.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 24.2.2023

Bashkia Lezhë nuk ka paraqitur pretendime me shkrim, as nuk është paraqitur në seancë publike.

Në raportimin e aktivitetit të parë në ndërfaqe deklarohet se do të jetë pjesëmarrëse media dhe që të jetë i hapur për publikun. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë Pjerin Ndreu, Kryetar i Bashkisë; Marte Fetaj, Drejtor; Punonjësit e Bashkisë dhe përfaqësues të OJF-së. Nisur nga tematika e aktivitetit “Nënshkrim marrëveshje” dhe nga sa informacion jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

Në raportimin e aktivitetit të dytë, deklarohet se do të jetë pjesëmarrëse media dhe që të jetë i hapur për publikun. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë Pjerin Ndreu (kryetari i Bashkisë) Flutura Aça, Tonin Çobani, Arben Prendi (shkrimtarë, publicistë, akademikë, punonjës të Bashkisë, etj). Nga verifikimet e kryera online, në rrjetin social Facebook, krijohet bindja se ka patur prezencë të publikut.

Edhe në raportimin e aktivitetit të tretë, deklarohet se do të jetë pjesëmarrëse media dhe që të jetë i hapur për publikun. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë Pjerin Ndreu (kryetari i Bashkisë) punonjës të institucionit të Bashkisë, banorë të zonës.

Në kuptim të nenit 92, pika 1 i Kodit Zgjedhor citohet se “Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të raportuara në ndërfaqe dhe hetimit të kryer, vlerëson se jemi përpara shkeljes së afatit 5 ditor të raportimit të veprimtarive me karakter publik dhe i tërheq vëmendjen Bashkisë Lezhë, që në vijimësi të marrë masa për të respektuar afatin ligjor, prej jo më vonë se 5 ditësh për raportimin e veprimtarive me karakter publik në faqen elektronike zyrtare të KQZ, e dedikuar për këtë qëllim.

13. Bashkia Mat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim i punimeve në vijimësi të punës së nisur në dhjetor 2022 për “Rehabilitimin e lagjeve Drita dhe Pjetër Budi”, raportuar në datën 21.2.2023 për t’u zhvilluar në datën 21.2.2023

Bashkia Mat, nëpërmjet email-it të datës 28.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Inspektimi i kryer nga Kryetari i Bashkisë, i raportuar dhe zhvilluar më datë 21.02.2023 u krye për shkak të situatës së krijuar nga konfliktet dhe pretendimet e banorëve për sipërfaqet e punimeve si dhe për hapësirat për parkimin e automjeteve në lagjet ku po kryhen punimet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkiake, nisur nga këto rrethana ishte e detyrueshme dhe e nevojshme një takim me banorë të lagjeve për tu sqaruar dhe dakortësuar për punimet që kryhen për “Rehabilitimin e lagjeve Drita dhe Pjetër Budi”, aktivitet i cili nuk ishte i planifikuar por që lindi nevoja për tu zhvilluar”.*

Nga verifikimet e kryera online, në rrjetin social Facebook, Bashkia Mat e ka publikuar veprimtarinë. Nga sa parashtrohet nga Bashkia Mat, raportimi jashtë afatit ka ardhur si pasojë e situatave emergjente për të adresuar konfliktet e lindura me banorët. Mosrespektimi i këtij detyrimi ligjor nuk ka ardhur për mungesë të vullnetit të institucionit raportues, por për shkaqe të tjera të pavarura prej tyre.

Për këtë arsye, i tërheqim vëmendjen Bashkisë Mat që në vijim, të kryejnë raportimin e veprimtarive duke bërë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

14. Bashkia Roskovec ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktiviteti "Shpërndarja e kontinierëve të dhuruar nga ambasada Japoneze në territorin e bashkisë" raportuar në datën 22.2.2023 për t'u zhvilluar në datën 2.2.2023.

Bashkia Roskovec, nëpërmjet email-it të datës 25.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *"Lidhur me aktivitetin e publikuar për shpërndarjen e kontinierëve, është bërë një lapsus në shënimin e datës 2.2.2023 pasi së pari kjo datë ka kaluar, por i referohemi datës 2.3.2023. Për sa më sipër, do të bëjmë ripublikimin e këtij eventit me datën e saktë. Theksojmë se sistemi nuk te lejon te besh korrigjimin e publikimit."*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Bashkia Roskovec ka kryer një gabim material për datën e zhvillimit të aktivitetit dhe në datën 24.2.2023 e ka riraportuar këtë aktivitet duke vendosur datën e saktë të zhvillimit të veprimtarisë (datë 2.3.2023). Në këto kushtet vlerësohet se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

15. Bashkia Sarandë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktiviteti "Me rastin e ditës ndërkombëtare të gjuhës amtare aktiviteti do të fokusohet tek recitimi nga nxënës të shkollave 9-vjecare i poezive për gjuhën e veçanërisht poezi të poetit Naim Frashëri "Gjuha jonë, sa e mirë", raportuar në datën 17.2.2023 për tu zhvilluar në datën 21.2.2023

Bashkia Sarandë nëpërmjet email-it të datës 28.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *"Në vijim të komunikimit me ju, lidhur me mosraportimin për veprimtarinë e datës 24.1.2023 sqarimit tonë të mëparshëm po i shtojmë se: Kjo veprimtari nuk është shoqëruar me raportim nga ana jonë në faqen e KQZ-së pasi bëhet fjalë për një datë përpara se Bashkia jonë dhe përfaqësuesi jonë të merrte kredencialet përkatëse nga ana juaj. Kredencialet për raportimin e aktiviteteve të planifikuara nga Bashkia Sarandë janë marrë në datën 27.1.2023. Kërkojmë të shtojmë se pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm për momentin është vakant dhe emri i personit përgjegjës i dërguar nga ana jonë është refuzuar."*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Bashkia Sarandë është e pajisur me kredencialet përkatëse, që prej datës 27.1.2023, çka i jep mundësinë që çdo raportim ta kryejnë online, nga kjo datë e në vijim. Gjithashtu, edhe nëse do të ndodhemi në kushtet e pamundësisë për të aksesuar ndërfaqen, ekziston mundësia e dërgimit nëpërmjet postës elektronike ose shkresë zyrtare.

Nisur nga tematika e aktivitetit “Me rastin e ditës ndërkombëtare të gjuhës amtare aktiviteti do të fokusohet tek recitimi nga nxënës të shkollave 9-vjecare i poezive për gjuhën e vecanërisht poezi të poetit Naim Frashëri “Gjuha jonë, sa e mirë”, dhe nga sa informacion jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe, ku citohet se nuk ka prezencë të medias dhe të publikut, nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

Për këtë arsye, i tërheqim vëmendjen Bashkisë Sarandë, që në vijim, të kryejnë raportimin e veprimtarive duke bërë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92 pika 2 të Kodit Zgjedhor.

16. Bashkia Shkodër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Tryezë diskutimi mbi mundësitë e zhvillimit të bizneseve të zonës së bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës” raportuar në datën 17.2.2023 për tu zhvilluar në datën 20.2.2023
- Aktiviteti “Takimi i rradhës së KVSP-së. Ky takim zhvillohet në kuadër të projektit RAYS, ku në fokus do të jetë “Vlerësimi Strategjik i Riskut” raportuar në datën 20.2.2023 për tu zhvilluar në datën 24.2.2023
- Aktiviteti “Pjesëmarrje në takimin me të rinjtë e Këshillit Rinor Arka në kuadër të projektit Youth RAP”, raportuar në datën 20.2.2023 për tu zhvilluar në datën 24.2.2023

Bashkia Shkodër nëpërmjet email-it të datës 1.3.2023 ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Bashkia Shkodër nuk ka qenë në rolin e organizatorit të këtyre aktiviteteve, por në cilësinë e të ftuarit. Në lidhje me aktivitetin “Tryezë diskutimi mbi mundësitë e zhvillimit të bizneseve të zonës së bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës”, raportuar më 17.2.2023 dhe datë zhvillimi 20.2.2023, ky aktivitet nuk është zhvilluar. Ju sqarojmë se roli i Bashkisë Shkodër në aktivitetin e dytë dhe te tretë ka qenë i pjesëmarrjes dhe jo organizator i këtyre aktiviteteve. Një gjë e tillë është specifikuar edhe në pjesën përshkrimore të raportimit në ndërfaqen e KQZ-së, secili aktivitet ka për organizator një palë të 3-të, sipas rastit. Nisur nga fakti se këto aktivitete nuk kanë për organizator Bashkinë Shkodër, gjykojmë se ato nuk janë objekt shqyrtimit nga ana juaj për mosrespektim të afateve të përcaktuara në nenin 92, pika 2. Për sa argumentuam më sipër, me qëllim për mos të rënë në përsëritje kërkua nga ana juaj të na sqaroni nëse janë objekt raportimi aktivitetet që vetë institucioni organizon apo edhe aktivitete të realizuara nga partner kombëtarë/ndërkombëtar, për të cilat titullari i*

Institucionit merr ftesë. Nga ana juaj nëpërmjet email-it zyrtar është kthyer përgjigje më datë 21.2.2023, ku citohet se: "Institucionet publike qendrore dhe vendore, kanë detyrimin ligjor për të raportuar veprimtaritë publike të cilat zhvillojnë/organizojnë, duke përjashtuar ato veprimtari në të cilat ndodhen në cilësinë e të ftuarit".

Për sa i përket aktivitetit të parë "Tryezë diskutimi mbi mundësitë e zhvillimit të bizneseve të zonës së bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës", ky aktivitet nuk është zhvilluar. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është zhvilluar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se për aktivitetin e dytë dhe të tretë, Bashkia Shkodër nuk ka pasur detyrimin të raportojë për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

17. Bashkia Tepelenë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktiviteti "Mbledhje e radhës e Këshillit Bashkiak", raportuar në datën 20.2.2023 për tu zhvilluar në datën 23.2.2023.

Bashkia Tepelenë nëpërmjet email-it të datës 27.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Lidhur me këtë njoftim ka raportuar pranë KQZ-së në datë 20.2.2023 për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë, i cili do të zhvillohej në datë 23.2.2023 për arsye të datës 18, datë në të cilën duhej të raportohet kjo veprimtari (5 ditë para mbledhjes) ishte ditë e shtunë dhe për këtë arsye kemi raportuar ditën e hënë 20 shkurt 2023.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se aktiviteti i raportuar prej Bashkisë Tepelenë, zhvillohet sipas programit të punës që ka institucioni, dhe këto mbledhje nuk janë aktivitete që zhvillohen me qëllim krijim informacioni për publikun, por janë të detyrueshme dhe vendimmarrëse për ecurinë dhe zhvillimin normal të institucionit. Në vetvete, përbëjnë veprimtari administrative që lidhen me veprimtarinë funksionale të institucionit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "n" dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe

monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOS:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,
 - b) Ministria e Turizmit,
 - c) Ministër i Shtetit për Standardet dhe Shërbimet,
 - ç) Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin,
 - d) Banka e Shqipërisë,
 - dh) Muzeu Historik Kombëtar,
 - e) Agjencia Kombëtare e Arsimit Formimit Profesional,
 - ë) Instituti i Sigurimeve Shoqërore,
 - f) Shërbimi i Provës,
 - g) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë,
 - gj) Bashkia Kurbin,
 - h) Bashkia Lezhë,
 - i) Bashkia Mat,
 - j) Bashkia Roskovec ,
 - k) Bashkia Sarandë,
 - l) Bashkia Shkodër,
 - ll) Bashkia Tepelenë.
2. Tërheqje vëmendje ndaj Bashkisë Lezhë, Bashkisë Mat, Bashkisë Sarandë dhe Shërbimit të Provës që të marrin masa të menjëhershme dhe të raportojnë veprimtaritë publike brenda afatit ligjor.
3. Ky vendim t’u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI